



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 21
02.06.2017

NR. VENDIMI 18
03.06.2017

Vendim -
“ Ne emer te Republikes”

Gjykata e Shkallës së Parë
për Krime të Renda Tiranë e përbërë prej:

Gjyqtare : Iliriana OLLDASHI

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Lavdie Hysaj**, sot në datën **03/06/2017**, ora **10:00 në Tiranë**, mori ne shqyrtim ne seancë gjyqësore kërkesën **nr. 21 akti**, që i përket :

Kerkues: Prokuroria prane Gjykeses se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane, **perfaqesuar ne gjykim nga prokurorja Sonila Muhametaj (ne seancen e dates 03/06/2017 ne mungese)**

KUNDER

- 1. S.C**, e datelindjes **XX/XX/XXXX**, mbajtese e pasaportes me nr. **XX XXXXXX**, shtetase italiane (ne mungese)
- 2. Shoqerise “XXXXX” sh.p.k. me seli ne Kavaje** me ortake te vetme dhe administratore shtetasen **S.C**, me Nipt **XXXXXXXXX**, date themelimi **08.07.2014**, me seli ne Lagja nr. **X**, Kavaje, ZK nr. **XXXX**, nr.

Pasurie X/XXX, godina nr. XXXX, Kavaje (ne mungese) .

Objekti: Revokim te sekuestrimit te pasurise.

Baza ligjore: Ligji nr. 10192 date 03/12/2009 “Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimin te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese kunder Pasurise”.

3

Ne seancen e dates 03/06/2017, ora 10:00, nuk u paraqit pala kerkuese Prokuroria per Krime te Renda Tirane, nga hetimi i shkaqeve te mosparaqitjes se tyre dhe shqyrtimi i akteve te njoftimit, kjo gjykate:

Konstaton se

Ne seancen e sotme gjyqesore te dates 03/06/2017, ora 10:00 nuk u paraqit pala kerkuese **Prokuroria per Krime te Renda Tirane.**

Nga hetimi i akteve te njoftimit te saj kjo gjykate konstaton se prokurorja Sonila Muhametaj, qe perfaqeson **Prokurorine per Krime te Renda ne gjykimin e kesaj kerkese eshte njoftuar rregullisht per zhvillimin e kesaj seance me aktin e njoftimit perkates dhe ka marre dijeni te rregullt per ditën dhe oren e zhvillimit te seances se sotme gjyqesore. Pervec ketij njoftimi shkresor ka patur dhe nje njoftim nepermjet telefonit nga kryesekretaria e kesaj gjykate. Po ashtu nuk i ka bere te ditur asnje shkak kesaj gjykate per mungesen e saj, fakt mbi te cilin kjo gjykate e konsideron te paarsyeshme mungesen.**

Personat e interesuar per shqyrtimin e kesaj kerkese shtetasen **S.C dhe Shoqerine “XXXXX” sh.p.k. me seli ne Kavaje** me ortake te vetme dhe administratore shtetasen **S.C,** kjo gjykate nuk i ka njoftuar ne seancen e sotme per shkak te mungeses se nje adrese te pasqyruar per kete shtetase (detyrim i papermbushur nga pala kerkuese).

Ne zbatim te nenit 27 te ligjit **nr. 10192 date 03/12/2009** dhe nenit 179/1 i Kodit te procedures civile i cili parashikon per nje rast te tille pushimin e gjykimit dhe ne baze te nenit 299/ç te Kodit te procedures civile, i cili percakton si rast te pushimit te gjykimit dhe ate kur ai eshte parashikuar shprehimisht ne ligj, kjo gjykate konkludon se ky gjykim duhet te pushohet.

Per çka dhe si u arsyetua me siper ne baze te neneve 27 te ligjit **nr. 10192 date 03/12/2009**, 179/1 dhe 299/c te Kodit te procedures civile, kjo gjykate pasi formoi bindjen ne baze te akteve te ketij gjykimi:

VENDOSI

Pushimin e gjykimit te kerkeses, **per shkak te mosparaqitjes se kerkueses ne gjykim.**

Kunder ketij vendimi mund te behet ankimi veçante ne Gjykatën e Apelit per Krime te Renda Tirane.

U shpall sot ne Tirane, ne daten 03/06/2017

SEKRETARE

Lavdie HYSAJ

GJYQTARE

Iliriana OLLDASHI

